

Z. Aldo Kume është diplomuar në vitin 2010 pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknike dhe në vitin 2012 është diplomuar për Master Shkencor në Hidroteknikë. Në periudhën 2010-2015, z. Kume ka punuar në sektorin privat, me projekte të ndryshme Infrastrukturore, Civile dhe Energjie në projektim, zbatim e mbikëqyrje. Në funksion të ushtrimit të profesionit disponon Licensat profesionale të Projektimit dhe të Vlerësuesit të Pasurive të Paluatjeshme.

Z. Kume ka filluar punë si auditues në KLSH më 01.06.2015, ku ka mbajtur pozicione të ndryshme si Auditues i Parë dhe Auditues i Lartë, si dhe ka qenë i angazhuar në të gjitha Departamentet e Auditimit, duke krijuar një eksperiencë dhe përvojë në auditim në të gjithë sektorët e administratës publike. Aktualisht ushtron detyrën e “Kryeaudituesit” në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Gjatë karrierës së tij profesionale në KLSH, ka marrë pjesë në disa konferenca, seminare dhe workshope të organizuara nga institucionet homologe ndërkombëtare konkretisht në Turqi, Luxemburg, Slloveni, Poloni, Belgjikë etj.

Nga viti 2020, z. Kume përfaqëson KLSH-në, në takimet e Bordit Ndërkombëtar të Audituesve për NATO-n (IBAN), i cili është organi i pavarur dhe i jashtëm i auditimit për NATO-n, përgjegjës për auditimet e pasqyrave financiare, auditimet e performancës për të gjitha subjektet raportuese të NATO-s, si dhe shpenzimet e Programit të Sigurisë dhe Investimeve të NATO-s.

Z. Kume është njohës i gjuhës angleze.